

Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Mesut Serhat Dinc
Drejtor i Përgjithshëm
KESCO sh.a

01 Nëntor 2021

Lënda: Propozimi për vlerat hyrëse dhe Shpenzimeve Operative për Furnizuesin me Shërbim Universal për periudhën 2022-2024

I nderuar z. Fejzullahu,

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka ri-hapur procesin për shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU) për periudhën trevjeçare 2022-2024.

Në përputhje me kërkesat e shkresës zyrtare nr. 497/21 të datës 12 tetor 2021, FSHU-ja ka parashikuar dhe plotësuar të dhënat sipas formateve të raportimit të dërguara nga ZRRE për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimeve operative për periudhën 2022-2024 dhe kërkon me mirësjellje nga ZRRE-ja të konsiderojë të gjitha komentet dhe argumentet e prezantuara gjatë përcaktimit të vlerave hyrëse për periudhën e ardhshme rregullative të FSHU-së.

Të dhënat e paraqitura janë argumentuara në formë të shkruar dhe janë mbështetur përmes kalkulimeve në shtojcat në formë tabelare. Për shkak të ndjeshmërisë së informatave, shtojcat në formë tabelare duhet të mbeten konfidenciale dhe vetëm për përdorim të ZRRE-së.

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe të këtij procesit na lejoni të theksojmë se ne jemi të hapur dhe të gatshëm për diskutime të mëtutjeshme kurdo që është e nevojshme.

Me respekt,


Mesut Serhat Dinc
Drejtor i Përgjithshëm, KESCO sh.a



***Propozimi për Vlerat Hyrëse 2022-2024 për
Furnizuesin me Shërbim Universal***

Përmbajtja

1.	Hyrje	3
2.	Jetëgjatësia ekonomike e asteve të FSHU-së dhe kërkesa për Investime kapitale dhe	3
3.	Marzha me pakicë.....	5
4.	Niveli i lejuar për borxhet e këqija	7
5.	Faktori Ndarës Balancues	9
6.	Shpenzimet Operative dhe kostot tjera	11
6.1.	Shpenzimet Operative dhe të mirëmbajtjes.....	11
7.	Përfundim.....	13

1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë përmes shkresës zyrtare nr. 497/21 të datës 12 tetor 2021 drejtuar KESCO-s si Furnizues me Shërbim Universal (FSHU) ka ri-hapur procesin për shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe shpenzimeve Operative për periudhën 2022-2024.

Procesi i përcaktimit të vlerave hyrëse kishte filluar më 10 shtator 2020, mirëpo nuk ishte mbyllur për arsye të mungesës së Bordit funksional të ZRRE-së. Pas kompletimit të Bordit, ZRRE-ja ka rihapur procesin e shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative për FSHU-në që do të vendosen për periudhën tre-vjeçare 2022-2024.

Marrë parasysh që në fund të vitit 2016 dhe fillim të vitit 2017, legjislacioni në sektorin e energjisë elektrike ka ndryshuar për të përmbushur kërkesat ligjore që rrjedhin nga Pakoja e Tretë e BE-së për Energji, ZRRE-ja ka vlerësuar si të nevojshme rivlerësimin e kushteve të furnizimit me shërbimin universal, përkatësisht rivlerësimin e vlerave hyrëse dhe përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale.

Vlerat hyrëse janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të rregulluara të Furnizuesit me Shërbim Universal. Komfor Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU-së), Neni 9, paragrafi 2, shqyrtimet e vlerave hyrëse duhet të iniciohen nga Rregullatori. Vlerat hyrëse përbëhen nga:

1. Jetëgjatësia ekonomike e aseteve të FSHU-së
2. Marzha me pakicë
3. Niveli i lejuar për borxhet e këqija
4. Faktori ndarës balancues, dhe
5. Ndonjë parametër tjetër hyrës që rregullatori mund ta konsideroj të nevojshme.

Komfor Neni 12, paragrafi 4, marzha me pakicë, niveli i lejuar për borxhet e këqija dhe faktori ndarës i jobalancit janë vlera hyrëse që përcaktohen për një periudhë 3 vjeçare.

ZRRE-ja përmes shkresës ka kërkuar nga KESCO gjithashtu të prezantoj kostot e lejuara dhe ato aktuale, kostot operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe kostot kapitale për periudhën 2017-2021, si dhe propozimin për tri vitet e ardhshme 2022-2024. Në dokumentin në vazhdim kemi prezantuar kërkesat dhe arsyetimet lidhur me parametrat rregullativ dhe shpenzimet operative për Furnizuesin me Shërbim Universal.

2. Jetëgjatësia ekonomike e aseteve të FSHU-së dhe kërkesa për Investime kapitale

Në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, kostot e zhvlerësimit llogariten duke përdorur Jetëgjatësinë Ekonomike të Aseteve, të përcaktuara për klasa të ndryshme të aseteve, ashtu siç janë aprovuar nga Rregullatori gjatë përcaktimit të vlerave hyrëse.

Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka investime të kufizuara kapitale, të cilat kryesisht janë të kufizuara në pajisjet e zyrës dhe Teknologji Informative (IT). ZRRE-ja që nga periudha e parë rregullative ka aplikuar zhvlerësimin për shpenzimet kapitale të FSHU-së me jetëgjatësi prej 5 vitesh.

Në vitin 2017, ZRRE-ja hapi procesin e rishikimit të vlerave hyrëse për operatorët e shpërndarjes dhe transmetimit. Për kategorinë ekuivalente të pajisjeve të zyrës, pajisjeve të IT-së dhe programeve kompjuterike (softuerëve), të cilat janë të zbatueshme për furnizuesin, ZRRE ka vendosur që jetëgjatësia e aseteve për operatorët e sistemeve të jetë 5 vjet.

Duke marrë parasysh jetëgjatësinë aktuale të aseteve dhe zhvillimet në sektorin e IT-së, ne besojmë se ZRRE-ja duhet të caktojë jetëgjatësinë e pajisjeve të zyrës për 5 vite, ngjashëm me operatorët e shpërndarjes dhe transmetimit. Sidoqoftë, sa i përket pajisjeve të IT dhe programeve kompjuterike, KESCO propozon që jetëgjatësia të përcaktohet për 3 vjet, për t'iu përgjigjur kërkesave bashkëkohore të sistemeve elektroenergjetike. Tabela në vijim tregon mesataren e viteve që kompanitë e ndryshme ndërkombëtare përdorin për zhvlerësimin e softuerëve:

Mesatarja e zhvlerësimin të programeve softuerike	
Kompania	Jetëgjatësia e aseteve
Apple	3-5 vite
Microsoft	3-7 vite
Facebook	2-5 vite
Johnson&Johnson	3-8 vite
Proctor and Gamble	3-5 vite
NVIDIA	3-5 vite
Home Depot	3-6 vite
Burimi: Të dhënat nga kompanitë sipas hulumtimit të Andrew Sather Linku: https://investingforbeginners.com/computer-software-depreciation-accounting/	

Ne besojmë se periudha pesë vjeçare për pajisjet e zyrës dhe programet kompjuterike është e gjatë dhe këto pajisje nuk do të kenë vlerën ekonomike dhe teknike për t'iu përgjigjur kërkesave bashkëkohore të mjedisit që po ndryshon në vazhdimësi, andaj kërkojmë nga ZRRE të shqyrtoj ndarjen e jetëgjatësisë së aseteve të FSHU-së në dy grupe, siç është paraqitur në tabelën në vijim:

Grupet e zhvlerësimin	Jetëgjatësia e aseteve
Pajisjet e Zyrës	5 vite
Programet kompjuterike	3 vite

Të dhënat aktuale tregojnë se ndarja e investimeve kapitale të FSHU-së përgjatë viteve janë mbi 60% në kategorinë 'Pajisjet e Zyrës'. Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e kostove ndërmjet pajisjeve të zyrës dhe IT-së në tre vitet e fundit:

Grupet e zhvlerësimin	2019	2020	2021
Pajisjet e Zyrës	63%	67%	73%
Programet kompjuterike	37%	33%	27%

Megjithatë, për shkak të zhvillimeve që nga shturja ligjore dhe funksionale nga operatori i shpërndarjes, furnizuesi KESCO është përballur vazhdimisht me ndryshime të mëdha në funksionimin e përditshëm, përfshirë hapjen e tregut, derregullimin e konsumatorëve, fillimin e operimit të konsumatorëve prodhues, funksionalizimin e mekanizmit balancues, etj. Marrë parasysh buxhetin e limituar të lejuar për investime kapitale dhe rritjen e theksuar të nevojës për përditësimin e sistemit të operimit të furnizuesit, në vitet e ardhshme është domosdoshmëri lejimi i buxhetit më të lartë për të mundësuar investimet e nevojshme në sistemin e operimit (faturimi dhe CRM). Tabela e mëposhtme përmbledh CAPEX-in aktual për periudhën 2019-2021 dhe kërkesën për 2022-2024.

	në '000 €	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Kostot aktuale (2019-2021)		250	182	218
Buxheti i kërkuar (2022-2024)		1,614	1,514	1,314

3. Marzha me pakicë

Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) është furnizuesi të cilit detyrimi për shërbimit publik i vendoset nga Rregullatori. Në këmbim të dhënies së të drejtës ekskluzive për të shitur energji elektrike në një territor të caktuar shërbimi, Rregullatori përcakton se cilat janë kostot e lejuara për operim, sa mund t'i ngarkoj konsumatorët fundor dhe cila mund të jetë marzha me pakicë.

Furnizuesit me Shërbim Universal në gjithë botën janë kompani të rregulluara, që nuk operojnë në një sistem të lirë të tregut ku çmimet dhe fitimet përcaktohen nga gatishmëria e konsumatorëve për të paguar. Në vend të kësaj, rregullatorët përmes përcaktimit të një marzhe me pakicë u garantojnë një kthim monetar, por njëkohësisht i mbrojnë konsumatorët fundor duke vendosur çmime të rregulluara për ta.

Neni 17, paragrafi 8, i Rregullës për të hyrat e FSHU-së përcakton që *“Marzha me pakicë do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e lejuara të energjisë me shumicë. Ajo duhet të caktohet në atë nivel që:*

- 8.1. T'i siguroj FSHU-së përfitim të arsyeshëm, që ta kompensoj për rreziqet që ndërmerr gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar marzhave të fituara nga kompanitë e ngjashme në vende të tjera në Evropë, duke marrë ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato vende dhe atë të Kosovës, dhe*
- 8.2. T'i siguroj FSHU-së kthim të arsyeshëm nga asetet fikse neto të saj të përdorura gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar kostos së kapitalit të të licencuarve të tjerë në Kosovë.’*

Marrë parasysh kushtet para privatizimit, Rregullatori përcaktoi marzhën me pakicë në 3% dhe si e tillë ishte e aplikueshme deri sot.

Një studim i bërë nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë (ECRB) në dhjetor të vitit 2013 tregon një qasje të ngjashme që zbatohet në të gjitha vendet fqinje sa i përket aplikimit të marzhës me pakicë¹. Përderisa kushtet e tregut dhe prioritetet e politikave kanë ndryshuar me kalimin e viteve, ashtu kanë ndryshuar edhe metodat për llogaritjen e marzhës me pakicë. Në këtë kuptim edhe marzhat me pakicë të aplikuara për Furnizuesit e Shërbimeve Universale në vendet fqinje ndryshojnë, p.sh. në Shqipëri marzha e shitjes me pakicë është një përqindje fikse e aplikuara ndaj kostove të lejuara të energjisë me shumicë, e cila përqindje lejohet nga Rregullatori (e përcaktuar në 3%), ndërsa në Maqedoninë e Veriut marzha e shitjes me pakicë vendoset përmes ankandit (ngjashëm me vendet e BE-së) e cila së fundmi u organizua në 2019 dhe marzha fituese ishte 11.5%².

Një studim i bërë nga Komisioni Evropian mbi Çmimet dhe Kostot e Energjisë në Evropë në 2019, tregon se shtetet anëtare rregullojnë përgjithësisht çmimet e energjisë me pakicë duke përdorur sisteme hibride, ku çmimet e rregulluara ekzistojnë brenda një tregu të liberalizuar me konkurrencën ndërmjet furnizuesve dhe mundësive për ndërrimin e furnizuesve. Në tregjet e rregulluara, marzha e shitjes me pakicë përcaktohet gjithashtu nga rregulloret dhe nganjëherë tendenca e rregullatorëve është që të vendosin marzhë shumë të ulët krahasuar me kostot aktuale neto, respektivisht shumë të ulët për të mundësuar konkurrencë efektive³. Përkatësisht, Furnizuesit e Rregulluar duhet të kenë marzhë më të madhe fitimi me qellim të promovimit të hapjes së tregut dhe arritjes së konkurrencës efektive në treg.

Raporti i Progresit për vitin 2021, vlerëson se Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie tregu funksionale dhe se mjedisi i biznesit ende përballet me shumë sfida⁴. Duhet të theksohet gjithashtu se edhe pse ka disa furnizues të licencuar, vetëm njëri prej tyre është aktiv dhe krahasuar me vendet e tjera fqinje Kosova ka normën më të ulët të furnizimit për konsumatorët aktiv të kualifikuar.

Shteti	Nr. i konsumatorëve	Raporti i furnizimit për konsumatorët aktiv të kualifikuar
Kosova	630,454	10%
Shqipëria	1,270,591	15%
Maqedonia	876,466	45%
Serbia	3,690,708	50%
Mali i Zi	404,785	96%

Burimi: Komuniteti i Energjisë, Fakte dhe Figura të Energjisë Elektrike për shtet 2020

Vlen të përmendet se derregullimi i konsumatorëve në vitin 2017 ka ndikuar në fitimin neto të Furnizuesit me Shërbimit Universal, pasi kostot e shitjes me shumicë përbënë rreth 50% të MAR-it të aprovuar, ndërsa konsumatorët industrialë në tregun e parregulluar përbëjnë 10% të konsumit në Kosovë.⁵ Respektivisht, raporti ndërmjet çmimit mesatar të blerjeve dhe çmimit mesatar të shitjes është zvogëluar që nga vitin 2017

¹ ECRB, Dhjetor 2013, Rishikimi i statusit të kriterëve kryesore për përcaktimin e të hyrave të lejuara për transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e rregulluar të energjisë elektrike dhe gazrave, https://www.energy-community.org/dam/jcr:f0feeb6e-96c9-48fd-b72e-d6cc7d8b0ef1/ECRB_revenue_determination.pdf


² Balkan Green Energy News, 2019, EVN-ja Austriake e fiton ELEM për t'u bërë furnizues universal <https://balkangreenenergynews.com/austrian-evn-outbids-elem-to-become-universal-supplier/>

³ Komisioni Evropian 2019, Çmimet e energjisë elektrike dhe kostot në Evropë, <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/10102/2019/EN/SWD-2019-1-F1-EN-MAIN-PART-5.PDF>

⁴ Raporti i Progresit për Kosovën, 2021, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

⁵ Të dhënat aktuale për vitin 2021

kur konsumatorët industrial të kyçur në nivel të transmisionit furnizohen në treg konkurrues, siç paraqitet në figurën vijuese:



Duke marrë parasysh derregullimin e ardhshëm sipas udhëzimit të ZRRE-së, fitimi neto aktual për Furnizuesin me Shërbim Universal do të jetë edhe më i ulët. Në këtë kuptim, bazuar edhe në atë se çfarë kemi thënë më lartë, ne besojmë se në këtë periudhë, marzha me pakicë duhet të përcaktohet si 3% për 3 vitet e ardhshme. Përcaktimi i marzhës me pakicë si 3% do të japë nxitje për Furnizuesin me Shërbim Universal për të vazhduar aktivitetet e tij të furnizimit më gjithë faktin se konsumatorët që janë pagues të rregullt po dalin në treg të parregulluar. Njëkohësisht, kjo përqindje do të ofroj hapësirë të mjaftueshëm për konkurrencë ndërmjet furnizuesve të rijë dhe do të rris interesimin e konsumatorëve për të kaluar në tregun e parregulluar.

4. Niveli i lejuar për borxhet e këqija

Borxhi i keq është një vlerësim dhe nivel i arsyeshëm i borxheve të këqija të shkaktuara nga Furnizuesi i Shërbimit Universal gjatë një viti përkatës. Sipas nenit 16 të Rregullave për të hyrat e FSHU-së, kostot e lejuara të borxhit të keq do të vendosen nga Rregullatori gjatë përcaktimit të vlerave hyrëse dhe do të llogaritet duke aplikuar nivelin e lejuar të borxhit të keq në llogaritjen fillestare të MAR-it. Diferenca ndërmjet MAR-it përfundimtar (që përfshin llogaritjen e borxhit të keq) dhe MAR-it fillestar përfaqëson kostot e borxhit të keq të lejuar për vitin përkatës.

Në periudhën e parë rregullative, ZRRE-ja përmes vendimit nr. V_399_2012 ka përcaktuar nivelin e lejuar për borxhet e këqija në 5% për 3 vitet e para dhe në 4% për 3 vitet e ardhshme (2012-2017). Niveli i njëjtë prej 4% vazhdoi të zbatohet deri më tani, megjithëse FSHU-ja në çdo rishikim tarifor ka kërkuar një nivel më të lartë për borxhet e këqija duke arsyetuar se niveli i lejuar për borxhet e këqija është më i ulët se ai i realizuar.

Gabimi më i zakonshëm që bëhet gjatë llogaritjes së nivelit të borxheve të këqija aktuale është konsiderimi i të gjitha të hyrave të furnizuesit KESCO-së. Është e rëndësishme të theksohet që KESCO si furnizues i licencuar pranon edhe pagesa të cilat nuk janë të ndërlidhura me energjinë e faturuar, ndërsa niveli i lejuar për borxhet

e këqija lejohet mbi bazën e MAR-it fillestar dhe si e tillë duhet të llogaritet vetëm në shumat e faturuara të energjisë elektrike për vitin përkatës. Tabela e mëposhtme tregon fuqinë e arkëtimit të Furnizuesit me Shërbim Universal që nga viti 2017:

Arkëtimi %	2017	2018	2019	2020	2021*	Total
Bazuar në MAR	94.7%	94.8%	95.9%	91.2%	96.9%	94.8%

* Pritshmëria në fund të vitit

Siç shihet në tabelën më lart, niveli aktual i borxheve të këqija që nga viti 2017 ka rezultuar me një mesatare prej 5.2%. Duhet të theksohet se viti 2020 është një vit i jashtëzakonshëm për shkak të përhapjes pandemike dhe efekteve të karantinës, e cila ka rezultuar me një nivel me të ultë të arkëtimit. Megjithatë edhe viti 2021 si i tillë nuk mund të merret për bazë meqë niveli me i lartë i arkëtimit rezulton për shkak të rikuperimit të vitit 2021. Në këtë kuptim, për të parë më qartë fuqinë arkëtuese, kemi analizuar arkëtimin për energjinë e faturuar gjatë një vitit e cila nuk arrin të tejkaloj nivelin prej 80%, ndërsa nëse përfshijmë edhe borxhet e viteve paraprake arrijmë tek mesatarja prej 94.8%, siç është paraqitur më poshtë:

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
2013	65.7%	25.1%	1.9%	1.1%	0.7%	0.5%	0.2%	0.1%	0.1%	95.5%
2014		75.1%	15.8%	1.8%	1.0%	0.8%	0.5%	0.2%	0.2%	95.4%
2015			76.2%	14.7%	1.7%	1.2%	0.7%	0.3%	0.3%	95.2%
2016				75.4%	15.6%	2.0%	1.1%	0.5%	0.4%	94.9%
2017					78.1%	14.1%	1.8%	0.7%	0.6%	95.3%
2018						77.5%	14.9%	1.3%	0.9%	94.5%
2019							79.3%	12.9%	1.8%	94.1%
2020								76.7%	19.4%	96.1%
2021									76.9%	76.9%

Meqenëse niveli i borxheve të këqija është një vlerësim dhe nivel i arsyeshëm i borxheve të këqija të shkaktuara gjatë një viti përkatës, duhet të theksohet se gjatë vendosjes së nivelit bazë në periudhën e parë rregullative, Rregullatori ka konsideruar situatën ekzistuese në atë kohë sa i përket arkëtimit, si dhe pa konsideruar ndonjë ndryshim të mëturjes në tregun e energjisë elektrike. Në kohën e vendosjes së këtyre parametrave për periudhën e parë rregullative, konsumatorët e kyçur në nivelin 220kV dhe 110 kV dhe konsumatorët industrial të kyçur në nivelet 35kV dhe 10 kV, me historik të arkëtimit me 100%, janë konsideruar në llogaritjen përfundimtare. Që kur kushtet e tregut kanë ndryshuar dhe tregu po hapet gradualisht këta konsumatorë po lëvizin drejt tarifave të parregulluara. Konsumatorët e kyçur në nivelet 220 kV dhe 110 kV tashmë janë duke u furnizuar në tregun e parregulluar. Sipas Udhëzimit të ZRRE-së mbi Liberalizimin e Tregut në Sektorin e Energjisë në Kosovë të aprovuar në 2017 dhe të ndryshuar më tej në vitet 2018 dhe 2019, dhe njoftimit zyrtar lëshuar gjatë vitit 2020, konsumatorët e kyçur në nivelet 35 kV dhe 10 kV pritet të furnizohen me tarifa të parregulluara nga prilli i vitit 2022. Në këtë kuptim, gjatë llogaritjes dhe përcaktimit të nivelit të lejuar të borxheve të këqija për periudhën e ardhshme rregullative (2022-2024), Rregullatori duhet të konsideroj gjithashtu largimin e këtyre konsumatorëve së bashku me mundësinë e tyre të pagesës, përkatësisht subvencioni i tërthortë duhet të eliminohet. Largimi i tyre nga të hyrat totale nuk ndryshon nivelin e borxheve të këqija që është i nevojshëm për funksionimin normal të Furnizuesit me Shërbim Universal, prandaj niveli i lejuar i borxheve të këqija duhet të rritet për të reflektuar arkëtimet më të ulëta.

Megjithëse lista e konsumatorëve që përmbushin kriteret për t'u furnizuar nga furnizuesi me shërbimin universal për konsumatorët e kyçur në nivelin 35 kV dhe 10 kV, ashtu siç përcaktohet në nenin 37, paragrafi 2

i Ligjit për Energjinë Elektrike, nuk është ofruar ende nga ZRRE-ja, KESCO si Furnizues me Shërbim Universal ka përdorur një listën e konsumatorëve të përcaktuar gjatë vitit 2020 dhe ka ri-llogaritur nivelin e arkëtimit për vitet 2020- 2021 pa përfshirjen e këtyre konsumatorëve potencial që pritet të furnizohen me tarifën e parregulluar nga prilli i vitit 2022. Ndryshimi i këtij efekti u konsiderua gjithashtu gjatë parashikimit të nivelit të lejuar për borxhet e këqija për periudhën tjetër rregullative.

Marrë parasysh të lartë-thënat, KESCO si Furnizues me Shërbim Universal ka bërë një analizë mbi pritshmërinë e arkëtimit të të hyrave (të arkëtueshmet) dhe ka rishikuar fuqinë e tij të arkëtimit për tre vitet e ardhshme (2022-2024), e cila është bërë komfor pritshmërive të reja dhe duke marrë parasysh informacionin e disponueshëm në kohë si: të dhënat historike mbi mundësinë e pagesave nga konsumatorët, numrin e bizneseve të mbyllura në baza vjetore, efektin e pandemisë dhe hapjen e tregut, propozimi përfundimtar është si më poshtë:

	2022	2023	2024
Kërkesa për nivelin e lejuar për borxhet e këqija	5.2	4.8	4.6

Ju lutem keni parasysh se kjo kërkesë nuk konsideron hapjen e tregut në nivel 0.4 kV, si dhe të drejtën e konsumatorëve për të ndërruar furnizuesin çdo 21 ditë, përfshirë edhe të drejtën e tyre për t'u kthyer tek Furnizuesi me Shërbim Universal (në rast se të njëjtit përmbushin kriteret), përkatësisht keqpërdorimin e mundshëm të konsumatorëve për të ndryshuar furnizuesit vazhdimisht, në mënyrë që të shmangin pagesat e tyre të fundit dhe respektivisht shmangien e shkyçjes. Kjo dukuri është shumë e shprehur dhe shqetësuese në vendet me tregje të zhvilluara të energjisë elektrike dhe një shqetësim i tillë është i pritshëm edhe tek ne.

E fundit por jo me pak e rëndësishme, Furnizuesi gjatë parashikimit të tij për vitet 2022-2024 nuk ka konsideruar ndryshim të tarifave fundore për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e furnizimit me shërbim universal. Përkatësisht, marrë parasysh krizën energjetike dhe çmimet aktuale të importit, përfshirë edhe planin afatgjatë të remonteve të njësisve gjeneruese B2 dhe B1 në dy vitet e ardhshme, pritshmëria për rritje të tarifave fundor është e evidente, megjithatë furnizuesi pa paragjykuar vendimet e ZRRE-së i ka konsideruar tarifën fundor të pandryshueshme. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se rritja eventuale e tarifave fundore do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në arkëtimin e furnizuesit, andaj është shumë e rëndësishme që gjatë përcaktimit të nivelit të lejuar të borxheve të këqija për periudhën rregullative 2022-2024, Rregullatori të këtë parasysh këtë fakt, me qëllim të sigurimit të stabilitetit financiar për furnizuesin e rregulluar, i cili tashmë dy vite radhazi po e mbyll vitin financiarë me humbje.

5. Faktori Ndarës Balancues

Neni 17 i Rregullës për të hyrat e FSHU-së përcakton që kostot e lejuara të energjisë me shumicë, që kanë të bëjnë me shërbimin për konsumatorët e rregulluar, përfshijnë ndër të tjera edhe kostot e jobalancit, të cilat i nënshtrohen faktorit ndarës të jobalancit. Paragrafi 5 i po këtij neni definon faktorin ndarës të jobalancit si në vijim:

“Faktori ndarës i jobalancit duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot neto të jobalancit për të përcaktuar ndarjen e këtyre shpenzimeve në mes të FSHU-së dhe konsumatorëve të rregulluar,

ku vlera prej 0% nënkupton që të gjitha kostot neto të jobalancit i alokohen FSHU-së, ndërsa vlera prej 100% nënkupton që të gjitha kostot neto të jobalancit u alokohen konsumatorëve. “

Duke marrë parasysh që komfor nenit 12 paragrafi 4, faktori i ndarjes i jobalancit është një vlerë hyrëse e përcaktuar për periudhën 3 vjeçare, neni 17, paragrafi 6 thekson se gjatë përcaktimit të faktorit ndarës të jobalancit, Rregullatori duhet të marrë parasysh se deri në ç’masë FSHU-ja është në gjendje të menaxhojë jobalancet, e në veçanti balancën ndërmjet furnizimit nga prodhimi vendor dhe importet e qëndrueshme, si dhe kërkesës së përmbushur nga FSHU-ja.

Gjithmonë ka pasiguri në parashikimin e kërkesës së konsumatorëve, respektivisht në blerjen e sasisë së saktë të energjisë për këtë kërkesë. Kërkesa e konsumatorit ndryshon gjatë gjithë vitit, muajit dhe gjatë ditës. Nëse furnizuesit kanë blerë më pak energji sesa është kërkesa e konsumatorëve, ata shkaktojnë kosto shtesë, jashtë kostove direkte për blerjen e energjisë me shumicë. Nëse furnizuesit kanë blerë më shumë energji sesa është kërkesa e konsumatorëve, ata mund të pranojnë pagesa por që mund të jetë e ndryshme dhe më e ulët sesa shitja e tyre me shumicë. Në këtë këndvështrim, ekziston rrezik për humbje dhe/apo përfitim për furnizuesit, varësisht nga kushtet e tregut. Në mënyrë që të shmangët ekspozimi i furnizuesve ndaj një rreziku më të lartë, përmes së cilëve furnizuesit do ta kishin të pamundur rikuperimin e kostove të tyre operative, Rregullatorët mbështesin furnizuesin duke prezantuar faktorin ndarës të jobalancit. Me krijimin e një trendi historik ndër vite, furnizuesit mund të parashikojnë dhe menaxhojnë më mirë këto kosto dhe Rregullatori mund të vendosë të ndryshojë përqindjen fikse që aplikohet në kostot neto të jobalancit (faktorin ndarës të jobalancit), pasi supozohet se lejimi i një faktori të ndarjes ndërmjet furnizuesit dhe konsumatorëve do të rrisë stimujt që furnizuesi të menaxhojë më saktë balancimin e tij.

Që nga funksionalizimi i mekanizmit balancues në Kosovë, në qershor të vitit 2017, faktori i ndarjes i jobalancit u aplikua si 100%, përkatësisht çdo përfitim dhe/apo humbje nga jobalancat iu kthyen plotësisht ose u rikuperuan plotësisht nga konsumatorët fundor. Shuma totale që konsumatorët përfituan në tarifa që atëherë është e barabartë me 2.27 milion €, siç tregohet në tabelën më poshtë:

Vitit	Përfitimi/Humbja në '000€
Qershor - Dhjetor 2017	785
2018	(698)
2019	26
2020	3,489
I-IX 2021	(1,328)
Total	2,274

Edhe pse ka një përfitim për furnizuesin që të kërkojë aplikimin e faktorit ndarës të jobalancit dhe se një kërkesë e tillë është në përputhje me përvojat ndërkombëtare, për shkak të numrit të kufizuar të pjesëmarrësve në treg, çështja e balancimit mbetet ende komplekse në Kosovë. Ndryshimet nga kërkesat e vendosura nga akterët e tregut, në një sistem jo mirë të avancuar nga perspektiva e infrastrukturës, janë shumë të vështira për t’u zbatuar praktikisht. Qasja e kufizuar në numër dhe llojllojshmëri të burimeve, dhe varësia nga njësitë gjeneruese të cilat janë të vjetra dhe jo fleksibile, kufizon aftësinë që sistemi të jetë në balancë dhe të ketë kosto minimale. Për më tepër, marrë parasysh edhe zhvillimet e tregut (konsumatorët prodhues, hapja e tregut dhe mundësia e ndërrimit të furnizuesve), ne besojmë se faktori i ndarjes i jobalancit duhet të vazhdojë të aplikohet si 100% të paktën deri në rishikimin tjetër periodik.

6. Shpenzimet Operative dhe kostot tjera

ZRRE përmes shkresës së saj ka kërkuar nga KESCO të paraqesë ndër të tjera edhe kostot aktuale dhe të parashikimin për shpenzimet operative, blerjet dhe shitjet e pritshme, të cilat janë thelbësore për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR).

ZRRE ende nuk ka aprovuar bilancin energjetik 10 vjeçar (2021-2030) dhe as bilancin vjetor të energjisë për vitin 2022, si dhe nuk ka dorëzuar ende listën e përditësuar të konsumatorëve të kyçur në nivelin 35 kV dhe listën e konsumatorëve të kyçur në nivelin 10 kV që do të furnizohen me tarifa të parregulluara nga prilli i vitit 2021, në përputhje me Udhëzimin mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë dhe amendamentet e tij. Duke marrë parasysh sa më sipër, Furnizuesi KESCO ka paraqitur kostot aktuale për vitet 2017-2021. Parashikimi i shitjeve është prezantuar në volume konform kërkesës se parashikuar nga furnizuesi të dorëzuar për parashikimin e bilancit energjetik 10 vjeçar, ndërsa blerjet do të mund të prezantohen sapo të kemi bilancin zyrtar të pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo ZRRE.

Sa i përket shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, marrë parasysh përcaktimin e vlerave hyrëse për tre vitet e ardhshme dhe ndryshimet e mundshme në treg, KESCO do të prezantoj më poshtë propozimin e tij për shpenzimet operative, duke mos parashikuar ndarjen e shërbimeve të përbashkëta.

6.1. Shpenzimet Operative dhe të mirëmbajtjes

Në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, FSHU-ja lejohet të shkaktojë kosto të arsyeshme, siç janë kostot e operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX), të cilat janë të domosdoshme për të mundësuar operimin e furnizuesit. Që nga shthurja funksionale dhe ligjore nga aktiviteti i shpërndarjes në vitin 2015, kostot mesatare të operimit dhe mirëmbajtjes të lejuar për Furnizuesin me Shërbimi Universal janë 5.6 milion € mesatarisht, të cilat janë në përputhje me kostot mesatare aktuale të realizuara nga furnizuesi me shërbimit universal, siç tregohet në tabelën më poshtë:

(në milion €)	2017	2018	2019	2020	2021	Mesatarja
Shpenzimet e aprovuara	5.79	5.96	6.06	4.59	4.61	5.40
Shpenzimet aktuale	5.60	6.14	5.56	5.37	5.33	5.60
Diferenca	0.18	(0.19)	0.50	(0.77)	(0.73)	(0.20)

**Ju lutem keni parasysh se kostot aktuale të OPEX-it nuk i përfshijnë shpenzimet për konsumatorët e parregulluar*

ZRRE aprovon në total shpenzimet operative për Furnizuesin me Shërbim Universal dhe ato nuk përputhen me kërkesat vjetore të furnizuesit gjatë viteve, pasi kostot e lejuara janë vazhdim i parashikimeve të bëra gjatë periudhës së parë rregullative dhe nuk paraqesin pasqyrim të ndryshimit të çmimeve gjatë viteve. Sidoqoftë, FSHU operon brenda buxhetit të lejuar, duke krijuar efikasitet kurdo që është e mundur në zëra të caktuara në mënyrë që të jetë në gjendje të mbulojë kostot e rritura në zëra tjerë. Prandaj ishte e papranueshme për FSHU-në kur gjatë përcaktimit të shpenzimeve operative për vitin 2020, ZRRE në mënyrë të njëanshme vendosi të ulë kostot për shërbimin e përbashkët pa i dhënë fillimisht të drejtën FSHU-së për të dhënë shpjegime në lidhje me shërbimet e përbashkëta dhe si e tillë e pengoi padrejtësisht të drejtën e FSHU-së për t'iu përgjigjur dhe argumentuar lidhur me këtë çështje. Kjo dukuri vazhdoi të trajtohet njëjloj edhe gjatë vitit

2021, duke krijuar rreth 1 milion € diferencë ndërmjet shpenzimeve operative të lejuara dhe atyre aktuale për aktivitetin e rregulluar.

ZRRE-ja gjatë përshtatjes së shpenzimeve të përbashkëta nuk mori parasysh shpenzimet e qirasë të cilat furnizuesi KESCO ia paguan Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të cilat për shkak të ndryshimeve të parimeve të kontabilitetit në Pasqyrat Financiare paraqiten në zë të ndarë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që gjatë përcaktimit të shpenzimeve operative të merren parasysh kostot aktuale dhe të justifikueshme përpara se të bëhen përshtatje që ndikojnë me mbi 25% të total kostove operative, ashtu siç është e rëndësishme të kërkohet sqarim dhe arsyetim nga të licencuarit përpara çdo përshtatjeje. Ulja e kostove operative për 25% e ka vendosur Furnizuesin e Shërbimit Universal në një pozicion shumë të pafavorshëm financiar, veçanërisht për faktin se FSHU-ja ka mbyllur vitin 2019 me humbje dhe në të njëjtën kohë gjatë vitit 2020 u përball me probleme të arkëtimit, si rezultat i përhapjes së pandemisë globale COVID-19. Për më tepër edhe kriza financiar e përhapur gjatë vitit 2021, me çmimet më të larta ndër vite që ka shënuar importi, përderisa tarifatat fundore mbeten të pandryshuara, ndikuan negativisht në fuqinë financiare të furnizuesit, duke rrezikuar kështu pagesat e përfshira në shpenzimeve operative (siç janë sigurimet, interesat e kredive dhe pagat e punëtorëve).

Duhet theksuar gjithashtu se përkundër faktit se numri i konsumatorëve është në rritje të vazhdueshme, e cila tutje rezultojnë edhe me rritjen e kostove për ofrimin e shërbimeve për këta konsumatorë, përkundër faktit se shërbimet për konsumatorët po përmirësohen, dhe përkundër se kostot për konsumatorë janë rritur ndër vite, ZRRE nuk lejoi buxhet të shtuar për mbulimin e kostove operative, megjithëse vazhdimisht është kërkuar dhe arsyetuar nga FSHU-ja nevoja për rritjen e shpenzimeve operative. Tabela më poshtë tregon humbjen vjetore të FSHU-së për kokë konsumatori gjatë viteve të fundit

	2017	2018	2019	2020	2021
Numri aktiv i konsumatorëve	561,827	579,963	605,694	630,454	646,385*
OPEX i lejuar (€)	5,787,503	5,957,047	6,060,104	4,594,113	4,606,095
OPEX-i i lejuar për konsumator	10.30	10.27	10.01	7.29	7.13
Ndryshimi i OPEX të lejuar për kokë konsumatori në vit (%)		-0.3%	-2.5%	-27.2%	2.2%
OPEX aktual (€)	5,603,000	6,143,000	5,556,232	5,367,580	5,332,977
OPEX aktual për konsumatorë	9.97	10.59	9.17	8.53	8.25
Ndryshimi i OPEX aktual për kokë konsumatori 2018 ndaj 2021 (%)					22%

*Numri aktual i konsumatorëve deri në shtator 2021

Siç mund të kuptojmë nga tabela e mësipërme, nga viti 2017 mesatarja e humbjes së FSHU-së sipas shpenzimeve operative të lejuara është afro 9%, e cila u rrit dukshëm me zvogëlimin e njëanshëm të shpenzimeve operative gjatë vitit 2020. Megjithatë edhe nëse krahasojmë shpenzimet operative aktuale nga vitit 2018 në 2021 kemi një ndryshim prej 23%, që dëshmon se FSHU-ja ka arritur optimizimin maksimal, për të cilat humbje FSHU nuk është kompensuar përmes OPEX-it të dhënë dhe të cilat do të jenë problematike për t'u arritur në të ardhmen nëse ZRRE-ja nuk merr në konsideratë kërkesat e FSHU-së.

Marrë parasysh të lartë thënat, si rezultat i rritjes së vazhdueshme të numrit të konsumatorëve dhe me qëllim të pasqyrimin të vëllimit të shtuar të detyrave / përgjegjësi në vendet e punës, FSHU parasheh një rritje pagash. Rritja e pagave ka për qëllim edhe nivelizimin e tyre me të licencuarit e tjerë në sektorin e energjisë

dhe njëherazi do të pasqyrojë vlerën e tyre për kompaninë, duke i mbajtur ata konkurrues në tregun e energjisë elektrike.

Marrë parasysh të lartë-thënat dhe nevojat e analizuar në detaje lidhur me kërkesat për zhvillimet e pritshme në tre vitet e ardhshme, OPEX-i i propozuar nga FSHU-ja për të siguruar operim të qëndrueshëm dhe funksional gjatë viteve 2021-2023 është si në vijim:

	2022	2023	2024
Kërkesa për Shpenzime operative dhe mirëmbajtje	6.80	6.87	6.89

Kërkesa e detajuar e OPEX-it është dhënë në Shtojcë, megjithatë duhet theksuar se rritja e kërkesës rezulton nga disa faktorë, të përmbledhur si në vijim:

1. Investimi në sistemin e ri të faturimit nënkupton trajnim shtesë për punëtorët e furnizuesit
2. Nevoja e furnizuesit për t'u pajisur me vetura, të cilat që nga shturja ligjore si asete i kanë takuar operatorit të shpërndarjes. Përdorimi i veturave nënkupton gjithashtu kosto shtesë për siguri, mirëmbajtje dhe karburant
3. Përhapja e pandemisë Covid-19 ka luhatur çmimet e sigurimit dhe ka rritur nevojën për siguri shtesë
4. Me qëllim të përfitimit nga kostot më të ulëta të importit, përfshirë marrëveshjet më afatgjate për import rritet nevoja për garanci bankare dhe kostot e financimit të tyre
5. Ndryshimi i vazhdueshëm i tregut dhe prezantimi i kërkesave të reja komfor zhvillimeve evropiane gjithashtu po rritë nevojën për konsulencë të brendshme si dhe informim më të mirë të qytetarëve lidhur me ndryshimet në shërbimet e ofruara.
6. Nivelizimi i pagave

Ju lutemi keni parasysh se ky buxhet nuk konsideron kostot operative për konsumatorët e parregulluar që pritet të furnizohen me tarifa të parregulluara nga prilli i vitit 2022. Duke marrë parasysh pasiguritë e hapjes së tregut, për shkak të pozitës së dëmtuar të bizneseve si rezultat i përhapjes së COVID-19, për sqarim KESCO ka alokuar 120,000 euro nga shpenzimet e pritshme operative për konsumatorët e parregulluar, të cilat janë kalkuluar konform numrit të pritshëm të punëtove të alokuar për konsumatorët e parregulluar dhe këto shpenzime janë zbritur nga kërkesa fillestare për shpenzime operative. Sapo të mundësohet hapja e tregut dhe konsumatorët e kyçur në nivelin 35 dhe 10 kV fillojnë të operojnë në treg të hapur me tarifa të parregulluara, KESCO planifikon të punësojë punëtor të rinj që do të merren drejtpërdrejt me konsumatorët e parregulluar. Kjo gjithashtu do të mundësojë monitorim më të lehtë të kostove të rregulluara dhe të parregulluara, ashtu siç kërkohet me licencën e KESCO-s dhe legjislacionet e tjera primare dhe sekondare në fuqi.

7. Përfundim

Jemi dëshmitar që në dy vitet e fundit si sektor i energjisë jemi përballur me të papritura, siç janë pandemia dhe kriza energjetike, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biznesin e rregulluar të FSHU-së. Rikuperimi nga

këto ngjarje deri në stabilizim po merr kohë. Prandaj para çdo vendimmarrjeve ZRRE duhet të ketë parasysh se vitet në vijim do të kemi jashtë funksioni një njësi gjeneruese të Kosovës B- e cila do të rrit varshmërinë nga importi, hapjen e tregut – e cila do të lë jashtë FSHU-së paguesit e rregullt, e deri te stabilizimi i çmimeve të energjisë elektrike (import dhe/apo çmime fundore), përkatësisht duhet të trajtohet ndikimi i tyre në sjelljen e pritshme të konsumatorëve dhe kapacitetin e blerjes dhe arkëtimit të FSHU-së.

KESCO si Furnizues me Shërbim Universal ka prezantuar propozimet dhe arsyetimet e veta lidhur me parametrat hyrës për periudhën 2022-2024. Së bashku me arsyetimet e lartpërmendura, FSHU dorëzon edhe modelet e plotësuara me kostot aktual dhe parashikimet dhe kërkon me mirësjellje nga ZRRE-ja të konsiderojë të gjitha komentet dhe argumentet e prezantuara gjatë përcaktimit të vlerave hyrëse për periudhën e ardhshme rregullative të FSHU-së.